



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 271/25 Datë: 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028):
 1. *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 R me kuotën maksimumi 15 studentë për vit akademik;*
 2. *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 R me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 3. *Prodhim Shtazor, BSc 180 R me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 4. *Shkencat e Aplikuara në Zooteknë, MSc 120 R me kuotën maksimumi 10 studentë për vit akademik;*
 5. *Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 R me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;*
 6. *Shkencat e Ushqimit, MSc 120 R me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
- II.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Prishtinës që deri me 30 shtator 2025, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Prishtinës të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 R</i>	Iliriana Miftari Nijazi Bytyqi
2.	<i>Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 R</i>	Arben Musliu Jehona Shkodra Fatos Krasniqi
3.	<i>Prodhim Shtazor, BSc 180 R</i>	Muhamet Kamberi Alltane Kryeziu Skender Muji
4.	<i>Shkencat e Aplikuara në Zootekni, MSc 120 R</i>	Bajram Berisha Blerta Mehmedi Kastrati
5.	<i>Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 R</i>	Xhavit Ramadani Salih Salihu Driton Sylejmani
6.	<i>Shkencat e Ushqimit, MSc 120 R</i>	Arbenita Hasani Rexhepi Rreze Gecaj Hysen Bytyqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120*, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: *Reiner Doluschitz, Joachim Muller dhe Matej Drobnic* është organizuar më 04.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë: Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit kurse Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.**
- Për programin e studimit; *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 R*, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: *Reiner Doluschitz, Joachim Muller dhe Matej Drobnic* është organizuar më 04.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht të gjitha shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.**

3. **Për programin e studimit; Prodhim Shtazor, BSc 180 R**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Doluschitz, Joachim Muller dhe Matej Drobnic është organizuar më 05.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë Plotësisht të gjitha shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.
4. **Për programin e studimit; Shkencat e Aplikuara në Zooteknë, MSc 120 R**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Doluschitz, Joachim Muller dhe Matej Drobnic është organizuar më 05.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht të gjitha shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.
5. **Për programin e studimit; Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 R**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Kyriaki Zinovadou, Jasna Novak dhe Jadranka Pelikan është organizuar më 17.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit, Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve kurse Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit, të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.
6. **Për programin e studimit; Shkencat e Ushqimit, MSc 120 R**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Kyriaki Zinovadou, Jasna Novak, dhe Jadranka Pelikan është organizuar më 17.12.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit, Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve kurse Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit, të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 135-të, të mbajtur më datë 10.03.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit të Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatën prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Asoc. Dr. Hashija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.